

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 3 (tre) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Bibliotekës Shkencore si më poshtë:

A. 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në pozicionin “Bibliotekar” në Sektorin e Shërbimit dhe Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të, në shkenca shoqërore.
2. Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze dhe italiane, e provuar me dëshmi.
3. Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite eksperiencë punë.
4. Të njohë në nivel shumë të mirë programet bazë të kompjuterit të provuara me dëshmi.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe aftësi të punës në grup.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore e largimit nga puna.
7. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
8. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në bibliotekonomi.

B. 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në pozicionin “Bibliograf” në Sektorin e Katalogimit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të, në shkenca shoqërore.
2. Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze dhe italiane, e provuar me dëshmi.
3. Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite eksperiencë punë.
4. Të njohë në nivel shumë të mirë programet bazë të kompjuterit të provuara me dëshmi.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe aftësi të punës në grup.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore e largimit nga puna.
7. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
8. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në bibliotekonomi.

C. 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në pozicionin “Përgjegjës IT” në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Digjtitimit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” në fushat inxhinierike.
2. Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi.
3. Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite eksperiencë punë.
4. Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhët e programimit Java, në gjuhën C të programimit, në planifikimin dhe krijimin e faqeve të internetit (Web Design) në dizajnin grafik (Web design) të provuara me dëshmi.
5. Të ketë njohuri dhe aftësi programuese në fushën e zhvillimit të aplikacioneve në Web. (Full-Stack Web Developer) të provuara me dëshmi.
6. Të ketë aftësi teknike në HTML, CSS, Figma, Trello, Matlab, Javascript, React, etj
7. Të ketë njohuri për sistemet e integruara bibliotekare, standardet dhe softwarët për menaxhimin e sistemeve të informacionit.
8. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe aftësi të punës në grup.
9. Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore e largimit nga puna.
10. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
11. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në bibliotekonomi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;

7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **05.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.